Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit, hap konkurs lidhur me pranimin e Praktikantëve, me pagesë 150 euro në muaj, për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit publikon këtë:

K O N K U R S
PËR PRAKTIKANT/E ME PAGESË
Nr. 01/2021

Për pranim të praktikantëve vullnetar:

Nr. 1	I N S T I T U C I O N I	Numri i Praktikanteve
1.	**Organi Shqyrtues i Prokurimit**	**3 praktikant/e**

Përshkrimi i punës së Praktikantit/es

Titulli i pozitës: Praktikant/e
Nëpunësi mbikëqyrës: Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së
Detyra e praktikantit: Ndihmon zyrën e Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së dhe administratën e OSHP-së, hartimin e shkresave dhe në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore:

- Migrimi i të dhënave nga webfaqja e vjetër në webfaqen e re të OSHP-së, dokumentet të cilat do të migrohen janë të gjitha të dhënat e faqes së vjetër nga viti 2008 deri në vitin 2019;
- Të gjitha vendimet e panelit dhe dokumentet e ndryshme që ne një herë i kemi publikuar, do të thotë që e gjithë puna këtu ka të bëjë me DATA ENTRY (Futjen e të dhënave);
- Ndihmon zyrën e Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së dhe administratën e OSHP-së, hartimin e shkresave dhe në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.
- Ndihmon Kryesuesin e Sekretariatit të OSHP-së, dhe Administratën e OSHP-së, në punët që kanë të bëjnë me futjen e shkresave nëpër lëndë, fotokopjimin e lëndëve, shpërndarjen e lëndëve për Panelet Shqyrtuese, përgatitjen e shkresave;

- Ndihmon në punë të ndryshme në Organin Shqyrtues të Prokurimit;
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojës.

Kualifikimet:

- Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik
- Njohuri të mjaftueshme lidhur me ligjet në Republikën e Kosovës;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të akteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, shkathtësi komunikimi për punë dhe aftësi të mira të punës me kompjuter.

Dokumentacioni për aplikim:

1. Diploma e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik
2. Letër motivuese;
3. Kopjen e letërnjoftimit.

VEREJTJE:

• Konkursi ngel i hapur 8 ditë nga dita e publikimit më datën: 28 / 01 / 2021 dhe mbyllet me datën : 04 / 02 /2021.
• Konkursin mund ta gjeni në web faqen www.oshp@rks-gov.net.

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Organin Shqyrtues të Prokurimit në Zyrën e Personelit, Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës se Lublanes, Kati i- V-të, ose përmes e-mailit : arta.S.berisha@rks-gov.net.

Për informata të tjera mund të lajmëroheni në numrin e Tel. 038/212-360, apo të shkruani në e-mail: arta.S.berisha@rks-gov.net.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara vetëm kandidatët të cilët i plotësojn kushtet, sipas konkursit, do të ftohen dhe kontaktohen për intervistim.